

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, i emëruar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/67, të datës 09.03.2022, si dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për emërimin e Komisionit të Auditimit në KRU "Hidromorava" Sh.A., nr. 201, të datës 22.01.2025, në pajtim me dispozitat e nenit 21 dhe nenit 25 pika (h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhur me nenin 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e katërt të rregullt, të mbajtur më datë 15.05.2026, merr këtë:

V E N D I M

1. **Z. Betim Jashari** emërohet në pozitën: **Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava" Sh.A.**
2. I emëruari sipas pikës 1 të këtij vendimi do të filloj punën me efekt nga data: 18.05.2026, të cilës do t'i paraprij nënshkrimi i kontratës së punësimit me përshkrimin e marrëdhënies së punës, detyrave punuese dhe përgjegjësisive për këtë pozitë.
3. Emërimi i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet me mandat tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan, ka zhvilluar procedurat e rekrutimit sipas Konkursit Publik nr. 183, të publikuar me datë 03.03.2026, për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe vlerësimit, Komisioni i Auditimit ka konstatuar se z. Betim Jashari i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkursin publik për këtë pozitë.

Me Vendimin nr. 481, të datës 29.04.2026, Komisioni i Auditimit ka marrë vendim për përzgjedhjen e z. Betim Jashari si kandidat i suksesshëm për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava" Sh.A.

Me vendimin e lartcekur është përcaktuar edhe e drejta e ankesës për kandidatët e pakënaqur. Pas përfundimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, janë krijuar kushtet ligjore për emërimin e kandidatit të përzgjedhur dhe lidhjen e kontratës së punës, me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse të pozitës.

Andaj, Komisioni i Auditimit, pas përmbylljes me sukses të procedurës së rekrutimit dhe krijimit të kushteve ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesja e Komisionit të Auditimit


(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)

